

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë kontestimore e shkallës së parë, sipas gjyqtarit Nexhat Aliu me sekretaren juridike Azize Rama, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit E. F. nga fsh.M.,K.Kllokot te cilin me autorizim e përfaqson F. H.. nga fsh.L., kundër të paditurve M.. M., (B) .M. V.B.. dhe M. B. (S.), të gjithë me adresë të pa njohur të cilet i përfaqson av. M. A. nga Vitia, me bazë të kontestit njohja e te drejtes së pronësi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe publik, me datë 07.06.2017 shpall këtë;

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET kërkesëpadia e paditësit E.F. nga M., K.Kllokot dhe **i njihet** drejta e pronësisë në ngastrat kadastrale nr.P-xxxx1, ne vendin e qujtur “ S. B.” ne siperfaqe prej xxx m2,e evidentuar ne emer të M.. V.(B), me kulture bujqso-re arë e klasit x, në siperfaqe prej xxx, 2) Tokë ndertimore-oborr në sipërfaqe prej xxx m2, 3. Tokë ndertimore - shtëpi ndertesë në sipërfaqe prej xxm2.

-Ngastra nr.P-xxxx2, ne vendin e qujtur “S. B.” ne siperfaqe prej xxm2,e evidentuar ne emer të M.. B... (S.), 1. Me kulture bujqso-re arë e klasit x, në sipërfaqe prej xxx m2, 2) Tokë ndertimore-oborr në sipërfaqe prej xxx m2, 3) Tokë ndertimore-shtëpi ndertes në sipërfaqe prej xxx m2.

-Ngastra nr.P-xxxx-3, ne vendin e qujtur “S. B..” ne siperfaqe prej xxx m2, e evidentuar ne emer të M... M.. (B), 1. Me kulture tokë ndertimore-oborr në sipërfaqe prej xxx m2, 2. Tokë ndertimore-shtëpi, ndertes në sipërfaqe prej xxxm2. ZK.M..., në bazë të shitblerjes.

DETYROHEN të paditurit M.. M.. (B.), M. V. (B.) dhe M. B.(S) t’ia njohin të drejtën e pronësisë paditësit E.. F.. dhe të durojë që ngastrat e lartpërmendur t’i regjistrohen në emrin e paditësit.

Ky Aktgjykim për Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi të Komunës së Kllokotit, paraqet bazë, që në regjistrat kadastralë, të bëhet ndryshimi.

II.Shpenzimet e procedurës do t’i heq paditësi.

A r s y e t i m

Përfaqësusja e paditësit E. F. ,F.H., ne seancen e dates xxx deklaron: Mbetem në tersi prane padise si dhe parashtreses të dt.xxx mbi ndryshimin dhe zgjerimin e kerkes padies ne kuptimin subjektiv dhe objektiv , dhe kerkoj nga Gjykata që ti

njihet e drejta e pronsisë paditësit ne ngastren kadastrale nr.xxxx ne siperfaqe prejxxxxm2, si dhe nr.xxxx-2 ne siperfaqe prej xxxxm2, dhe ngastren nr.xxxx-3 në siperfaqe prej xxxm2, qe te gjithe ZK-Mogillë,të cilat ngastra babai i paditesit M... F.. i kishte blerë palujtshmerit ne

vitin xxx duke e paguar qmimin në tëresi në baze te marrveshjes dhe vullnetit te lire ka hyr ne posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush , qe nga viti xxxx.

Përfaqesusja e paditesit E. F..F... H., i propozon Gjykates qe të paditurëve ti caktohet një përfaqësues të përkohshem, ku gjykata kishte vendosur duke caktuar përfaqësuesin e përkohëshem për të paditurit av. M. A.nga Vitia.

Përfaqesusja e paditësi E. F. , F. H.. në seancen e dt.xxxx, i ka propozuar gjykatës qe gjykata te caktoj një ekspert te gjeodezisë me qellim te identifikimit të ngastrave nr.xxx, nr.xxx, dhe ngastren nr.xxx, ZK.Mogillë.

Përfaqesusi i përkohshëm av.M. A. ka deklaruar:e kundërshtoj padien dhe kerkese padien e paditesit lidhur me bazushmerin e kerkes padise rezervoje te drejten qe te deklarohem pas administrimit te provave ne seancen tjeter.Nuk e kundërshtoj propozimin e perfaqesueses se paditsit per daljen ne vendin e ngjarjes se bashku me ekspertin e gjeodezisë me qellim qe te behet identifikimi i ketyre ngastrave të cilat jan objekt i kesaj kerkes padie.

Gjykata ka aprovuar propozimin e perfaqesueses së paditësit dhe së bashku me ekspertin e gjeodezisë ka dalur në vendin e ngjarjes me dt.xxxx, ka bërë identifikimin e ngastrave kadastrale nr. nr.xxx, nr.xxxx, dhe ngastren nr.xxxx te cilat ngastra shtrihen per nga gjatesia ne lindje -perndim ndersa per nga gjersia jug-veri, me kultur janë oborrë ne ngastren nr.xxxxx ka te ndretuar nje shtepi me matrial te forte dhe ne ngastren xxxx jan te ndertuara dy shtepi me matrial te fort ndersa ngastra me nr.xxxx nuk ka te ndertuar objekt.

Perfaqesuseja e paditesit E. F., F. H. i propozojne Gjykates që për seancën e radhës të ndëgjohen dy dëshmitare qe kane njohuri lidhur me shitblerjen e këtyre ngastrav. Gjykata kishte aprovuar propozimin e paditësit për ndëgjimin e dy dëshmitarve që kishin njohuri mbishitblerjen e këtyre ngastrave.

Dëshmitari R. N.. nga fsh.M... deklarone: Une jom fqinje i parë me keto ngastra dhe e difort mire se keto ngastra te paditurit V. M. (B.), dhe M. M.(B ja kan shitur babait te paditesit E. F. -M. F.a, ndersa emir I B.e M. ky person esht i vdekur dhe eshte baba i M.M. dhe V. M., këto ngastra jan shitur menjeher pase luftes ne vitin xxxx une kam qen prezent kur eshtë bërë marrveshja ne mes te babait te paditesit M. F. dhe M. M. ndersa për V. M. dhe B.. M..nuk kam qenë prezentë por kam ndëgjuar nga njerzit se edhe keta i kan shitur. Paditësi ka hyr ne posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush , unë nuk kam ndëgjuar qe te jet ankuar dikush nga te paditurit lidhur me qmimin e kontraktuar. Shitblerja eshte bere me marak Gj....

Deshmitari S. F. nga fsh.M..deklarone: Keto ngastra i ka bler mixha im M. F. nga te paditurit diku menjeher pas lufte por nuk e di se a ka qen viti i parë apo i dyte pas lufte , une kam qen prezent edhe kur eshte bere marrveshja ne mes babait te paditësit dhe të paditurve , dhe une kam qenë prezent kur ja kan dhënë të hollat shitblerja është bërë me valut gjermane (marka), dhe nuk kam ndëgjuar qe te jet ankuar dikushë lidhur me këto ngastra , paditësi ka hyr në posedim dhe shfrytëzim pa u penguar nga askush pasi qe kan ndertuar shtëpien e tyre.

Gjykata kishte lexuar dhe shtjelluar këto prova: Certifikata e pronës me nr.xx/1xx e dt.xxx. ne emer M. V. (B), me ngastrën kadastrale nr...xx Certifikata e pronës nr.x e dt.xxxx ne emer te M. M. (S)., me ngastrën kadastrale nr.xxxx, Lexohet Certifikata e pronës nr.xxx e dt.xxx ne emer të M.. M.. B.. Me ngastrën nr.xxx, Lexohet kontrata private e dt. xxxx e lidhur ne mes të F. M. dhe M.B. shiqohet kopja e planit pa numer. Pergjegjeja e AKP, me nr.REF.xxxx e dt.xxxx. Lexohet pergjegja e stacionit Policor në Kllokot e dt.xxx. Lexohet kerkesa e dt.xxx, e ushtruar nga F. H.Lexohet ekspertiza e matjeve gjeodezike e dt.cxxxx , e perpiluar nga gjeodeti V.S...

Përfaqshuesja e Paditësit E.F. - F.H. ne fjalen perfundimtare te palve ka deklaruar:Mbetem në tersi pran padis dhe precizimit te padise dhe kerkoj nga gjykata qe ti nihet e drejta e pronsis paditësit E.F., ne ngastrat kadastrale nr.xxxx ne sipërfaqe prej xxxxm2, ne vendin e quajtur "S.ee"ZK.M., si dhe ngastrën nr.xxxx ne sipërfaqe prej xxxxm2, në vendin e quajtur "Sx bx"si dhe ngastrën nr.xxxxx në sipërfaqe prej xxxxm2, ne vendin e quajtur"Sx bx"ZK.xx, të cilat ngastra babai i paditësit M.F.i kishte blere nga të paditurit , nga ajo kohë ka hyr ne posedim dhe shfrytezim pa u penguar nga askush. Andaj kërkoj nga gjykata qe ta aprovoj padien dhe procezimin e padis dhe ti njihet e drejta e pronsis paditësit E. F.ne ngastrat e lart permendura , nga se kjo eshte vertetuar mjaftë me daljen e gjykates ne vendin e ngjarjes dhe ndegjimin e dy deshmitarve te cilet u ndegjuan ne kete shqyrtim gjyqesor si dhe ekspertiza e ekspertit te gjeodezis jan provat e mjaftushme se ka ekzistuar nje raport juridiko civil ,zingjiror i pa shkruar ne mes te babait te paditesit dhe te paditurve, andaj kerkoj nga gjykata të merr një aktgjykim ne bazë provave -ligjit.

Përfaqshuesi i përkohshem i te paditurve M. M. (B , M. V. (Bl.), dhe M. B. (S.) av.M. A.në fjalen perfundimtare të palve ka deklaruar:pas mbajtjes se disa seancave gjyqesore është bërë mjaftë administrimi i provave andaj kërkoj nga gjykata që të vendos lidhur me padien e paditesit E. F. bazë te bindjes se lire te bazuar në dispozita ligjore që jan në fuqi.

Gjykata duke u bazuar ne nenin 8, të LPK-së, vlerësoi provat veç e veç dhe si tërësi.

- Me leximin e certifikatave të pronës, të dates xxxx dhe të dt.xxxx, me ngastrat kadastrale, xxxx-1, xxxx-xx2, dhe xxxx në emër të pronarve juridik Mxxx Vxxx(xxx), Mxxx Bxxxx(Sxx) dhe Mxxx Mxxx (Bxxx), gjykata vërteton se padia përputhet plotësisht në subjektet si palë kontestuese.

-Eksperiza e ekspertit të gjeodezisë tregon përputhshmërinë e kërkesëpadisë në aspektin formal me gjendjen faktike në teren, si dhe gjendjen aktuale mbi shfrytëzimin e këtyre ngastrave kadastrale.

-Deklaratat e dëshmitarve R. N.dhe S.F. të dhëna në seancën e fundit të shqyrtimit gjyqësor, e forcojnë kërkesën e paditësit në njërën anë dhe besimin e gjykatës për ekzistimin e punës juridike.

Gjykata ka vërtetuar se në mes paditësit E. F. babait të tij M.F. me të paditurit M. M. (B. , M. V. (B.), dhe M. B... (S.) kishte ekzistuar raporti juridik, i cili edhe pse jo i lidhur në formën e shkruar, ai ka prodhuar efekt juridik, me faktin se paditësi ka hy në posedim në të njëjtat palujtshmëri, të cilat edhe i mbanë më tej pa u penguar nga askush.

Gjykata për tërë këtë raport juridik mes palëve ndërgjyqëse u shërbye me të drejtën materiale e cila ishte në fuqi gjatë krijimit të këtyre raportëve, siç është neni 28, i LMD-së, sepse vullneti i palëve ka fuqi detyrimi dhe është mbi ligjin.

Andaj, gjykata duke u bazuar në gjitha këto prova dhe fakte të pakontestueshme, duke qenë e pavarur në vendosje miratoi kërkesëpadinë e paditësit.

Shpenzimet e procedurës do t'i bartë paditësi E.F..neni 453, i LPK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI

C.nr.291/2014

Më.07.06.2017

Sek. Juridike
Azize Rama

Gj y q t a r i,
Nexhat Aliu

UDHËZIMI PËR MJETIN JURIDIK: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimi të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.